




Pranimi / Dorezuar Priljeno/Prilato Received/Delivety	24. 11. 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilcg Appendis	Saara Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5652/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.868/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.868/2021 të datës 15.10.2021, të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.868/2021 të datës 15.10.2021, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja Drejtore në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, më datë 15.10.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokollit 14/116/01-196283/21 të datës 16.09.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, me pretendimet e shkeljeve të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 25.10.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës. Ndërsa më datë 15.11.2021 KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit të ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5056/2021 të datës 15.10.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.10.2021; Vendimin me numër protokollit 14/116/01-196283/21 të datës 16.09.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës; Vendimin për caktimin e ushtruesit të detyrës me Nr.14-112/02-0098951/21 i datës 01.06.2021; E-mail nga për i datës 22.08.2021; E-mail nga për i datës 11.06.2021; E-mail nga për i datës 11.06.2021; E-mail nga për i datës 10.06.2021; E-mail nga për i datës 12.08.2021; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 13.08.2021; E-mail nga për i datës 14.09.2021; E-mail nga për i datës 14.09.2021; Fletëthirrja e datës 14.09.2021; E-mail nga për datës 14.10.2021; E-mail nga për i datës 13.10.2021; E-mail nga për M.B. i datës 14.10.2021; E-mail nga për i datës 13.10.2021; E-mail nga për i datës 14.10.2021; E-mail nga për i datës 14.10.2021; Raport i datës 14.10.2021 1.Raporti i qasjes për të gjithë punëtorët e DSHPMSH-së 2. Screen shot nga sistemi i qasjes për të gjithë punëtorët e DSHPMSH-së; Njoftim për pranueshmëri i datës 10.09.2021; Formulari i regjistrimit të ankesës me nr.00907 i datës 19.07.2021; Njoftim me numër protokollit 4458/2021 i datës 01.09.2021; Ankesë me numër protokollit 4574 i datës 10.09.2021; E-mail nga për i datës 29.09.2021; E-mail nga për i datës 29.09.2021; E-mail nga për i datës 08.09.2021; E-mail nga për i datës 30.08.2021; E-mail nga për datës 01.10.2021; E-mail nga për i datës 31.08.2021; E-mail nga për i datës 30.08.2021; E-mail nga për i datës 29.09.2021; E-mail nga për i datës 08.09.2021; E-mail nga për i datës 31.08.2021; E-mail nga për i datës 30.08.2021; Ankesë me numër protokollit 3789 i datës 19.07.2021; E-mail nga për i datës 28.04.2021; E-mail nga për i datës 12.03.2021; E-mail nga për i datës 28.04.2021; E-mail nga për i datës 28.04.2021; E-mail nga për i datës 20.04.2021; Vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës me nr. 14-112/02-0098951/21 i datës 01.06.2021; Diplomë me nr.399 i datës 15.01.2009; Shtojca e Diplomës me numër protokollit 774 i datës 16.06.2021; Ankesë e datës 01.10.2021; E-mail nga për i datës 14.10.2021; Ankesë me numër protokollit 3789 i datës 19.07.2021; Formulari i ankesës me numër 00908 i datës 19.07.2021; Ankesë e datës 01.10.2021; Njoftim i datës 15.11.2021; Vendim për Emërimin e Drejtores të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit me numër protokollit 14-112/02-0069438/19 i datës 26.03.2019; Vendim i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës me numër protokollit 14-116/01-196283/21 i datës 16.09.2021; Fletëthirrja e datës 14.09.2021; E-mail nga për i datës 10.11.2021; E-mail nga M.Ll për M.B. i datës 14.09.2021; Vendim për caktimin e Ushtruesit të Detyrës me numër protokollit 14-112/02-0098951/21 i datës 01.06.2021; E-mail nga për i datës 12.08.2021; E-mail nga për i datës 22.07.2021; Raporti i një shkelje disiplinore të supozuar me numër protokollit 14-116/01-166213/21 i datës 13.08.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses *sepse:*

Nga provat e lëndës është konstatuar së ankuesja me Vendimin me nr. prot. 14-112/02-0069438/19 të datës 26.03.2019 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është emëruar Drejtor i Drejtorisë Komunale në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit'' në Komunën e Prishtinës, nga data 25.03.2019.



Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi nëpunës civil është ".....zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë" ndërsa sipas Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale respektivisht sipas nenit 65 të këtij ligji është përcaktuar së: Shërbimi civil komunal përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç: a) kryetarit, nënkryetarit/ve dhe drejtorëve komunal;, e mbi këtë bazë rrjedhe së pozita " Drejtor komunal" nuk hynë në kategorinë e nëpunësve civil, respektivisht ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit civil. Andaj gjykuar nga ky fakt, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në Shërbimin civil, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se KPMSHCK-ja nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuses

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.868/2021

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

